



SHOQERIA E RUAJTES DHE SIGURISE FIZIKE PELIKANI SECURITY 2

Autostrada Tirane-Durres km 9 Tirane-Shqipëri,
Tel: +355 4 2226001, Tel/Fax: +355 4 222 6440 , E-mail info@pelikanisecurity2.com
www.pelikanisecurity2.com CERTIFIKUAR NGA DNV ISO 9001 -2008



Nr 74 prot

Tirane me 14/04/2018

A U T O R I Z I M

Sote me date 14/04/2018 me ane te ketij autcrizimi i jap te gjitha tagrat ligjore zotit
Gezin Ramazan Demiraj me karte indentiteti 026041035 perfaqesuz shoqerise
PELIKANI SECURITY 2 shpk me nipi K71902030L

Te me perfaqesoje , shoqerin e Pelikani security 2 shpk ,prane QKB per kryerjen e
veprimeve ne emer dhe per llogari te saje

Per sa me siper te gjithe veprimet ligjore te lartepermendura ce do te kryej i porosituri nga
ana ime i konsideroj te ligjeshme dhe ne perputhje te plete me vullnetin tim te lire dhe te
plote dhe njesoj si te jeme vete i pranishem .

SHOQERIA PELIKANI SECURITY 2 SHPK

Oratku
Veset DEMIRAJ

Administrator
Aleksander PINDERI

Veset Demiraj



Aleksander Pinderi



**STATUTI
I SHOQERISE AKSIONARE
"PELIKANI MONDIALPOL" SH.A**

**TITULLI I
EMERTIMI I SHOQERISE - SELIA - KOHEZGJATJA**

Neni 1 - Emertimi i shoqerise

- 1.1 Si me poshte miratohet statuti i shoqerise aksionare me oferte private e quajtur "Pelikani Mondialpol" SIA (ne vijim "Shoqeria").
- 1.2 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 - Selia

- 2.1 Selia e Shoqeriseeshte ne Kashar, Lagjia Koder Kashar, Autostrada Tirane - Durres Km. 9, Rruga Iliria, Godina Nr. 1, Zona Kadastrale 2105, Tirane - Shqiperi.
- 2.2 Asambleja e Pergjithshme mund te vendose hapjen e filialeve, selive sekondare, degëve dhe zyrave te perfaqesimit ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.
- 2.3 Persa i perket marredhenieve midis Shoqerise dhe aksionereve (ne vijim "Aksionere" ose "Ortak"), adresa e secilit prej Aksionereve eshte ajo qe rezulton nga Regjistri i Aksionereve te Shoqerise. Nese do te ndryshohet adresa, Aksioncret detyrohen te njoftojne me shkrim Shoqerine dhe ky ndryshim duhet te regjistrohet ne Regjistrin e Aksionereve te Shoqerise.

Neni 3 - Kohezgjatja

- 3.1 Kohezgjatja e Shoqeriseeshte deri me 31/12/2050, me mundesine e zgjatjes se kesaj afati nje ose disa here nga Asambleja e Pergjithshme.
- 3.2 Shoqeria mund te priset me vendim te Asamblese se Pergjithshme ose sipas dispozitave te ligjit te zbatueshem.

**TITULLI II
OBJEKTI**

Neni 4 - Objekti

- 4.1 Objekti kryesor i Shoqeriseeshteshoqerimi, transportimi dhe depozitimi i objekteve me vlere, elementeve monetare dhe me vlere, per llogari te vet dhe per palet e treta, duke perdorur mjetet e tyre te transportit, te marra ne perdorim, qira dhe gjithashtu me leasing financiar, si edhe ruajtja e gjerave me vlere necaveaux dhe/ose kasaforta sigurie, menaxhimi isallave te numerimit dhe grumbullimit per perpunimin ne pergjithesi te parave, ceqëve te letrave me vlere dhe kuponavete tyre, kredi te asimiluara ne pronesi te paleve te treta, ne perputhje me kerkesat ligjore, sipas kategorise "C", si dhe çdo aktivitet ndihmes i nevojshem per tepermbushur dhe realizuar objektin e aktivitetit te siperpermcudur. Ky aktivitet do te krybet ne baze te fejeve dhe licencave perkatese te leshuara nga autoritetet kompetente.
- 4.2 prodhimi dhe shitja ne te gjitha format e veshjeve, ne veçanti te veshjeve teknike dhe ushtarake (uniformat e rojeve private. etj.).
- 4.3 menaxhimi i sherbimeve te sigurise ne zonat e portit dhe te aeroportit, veçanerisht mbikeqyrja e aeroportëve dhe portëve dhe pozicioneveto veçanta brenda zones se aeroportit dhe portit, qe i takojne shoqerive te menaxhimit, te transportuesit ajror ose ujer ose njcooperatori tjetër te




aeroportit dhe portit (hyrja, zyrat, portat e ngarkesave, perimetri i aeroportit dhe portit dhe uljet e levizshme); mbikqyrje e magazinave te mallrave import-eksport dhe portat e tyre perkatese, mbikqyrja e mallrave me vlerë te veçante se bashku me shoqerimin –ruajtjen ne magazinat e avioneve dhe/ose anije dhe / ose varkave dhe anasjelltas, shoqerimi-ruajtja e sendeve me vlerete pasagjereve, kontrolli me treze-x i bagazhit teregjistruar, bagazhit "Rush" dhe atij ne dore, njohja e bagazheve ne bord; kontrolli i pasagjereve negate/portat e hyrjes dhe ne aeroplan dhe/ose anije perpara imbarkimit efektiv, intervista me pasagjeret para imbarkimit.

- 4.4 Shoqeria mund te kryeje, gjithashtu, te gjitha veprimtarite qe rezultojne te nevojshme ose te dobishme per realizimin e qellimeve te saj; per shembull, Shoqeria mund te kryeje veprime me pasuri te pahuajtshme, me pasuri te fuajtshme, veprime tregtare, industriale dhe financiare, te marre pjese ne gara publike per te marre persiper administrimin e sherbimeve me interes ekonomik te pergjithshem ose aktivitetet te tjera gjithesci te dobishme per realizimin e objektit, si dhe çdo akt qeeshte gjithesci i lidhur me objektin e Shoqerise, me perjashtim te mbledhjes se kursimeve nga publiku i gjere dhe ushttrimin e aktiviteteve objekt te rezerves ligjore. Se fundi, Shoqeria mund te fitoje pjesemarrje dhe interesa ne shoqeri te tjera, konsorciume ose ndemarrje, vendase dhe te huaja, si dhe te themeloje shoqeri, me objekt te ngjashem, plotesues, ndihmes, analog ose te lidhur me te vetin ose me ate te shoqerive ne te cilat zoteron pjesemarrje, ose edhe qe kane objekt te udryshem, si direkt edhe indirekt, ne çfaredolloj forme, si dhe te administroje keto pjesemarrje dhe/ose interesa me kusht qe ato te mos modifikojne thelbin e qellimeve te Shoqerise; mund, gjithashtu, te jape garanci reale dhe/ose personale per detyrime te lidhura me realizimin e aktiviteteve te Shoqerise edhe ne favor te paleve te treta.

TITULLI III KAPITALI - AKSIONET - TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Neni 5 – Kapitali

- 5.1 Kapitali i nenshkruar dhe teresisht i paguar i Shoqerise eshte 9.800.000 Leke, i cili perbehet nga 5.000 (pesemije) aksione me nje vlerë nominale prej 1960 Leke secili. Kapitali eshte nenshkruar dhe paguar si me poshte:
- Z. Vesel Demiraj, lindur me 13.02.1967, ne Lalez, Durres, mbajtes i pasaportes me nr. BB8676968, e nr personal G70213046W, zoteron 5000 aksione me vlerë 1960 secili, te cilat perbejne 100% te kapitalit kapitalit themeltar me nje vlerë prej 9.800.000 Leke;
- 5.2 Asambleja e Pergjithshme mund te zmadhoje kapitalin ne perputhje me ligjin. Pervec rasteve te parashikuara shprehimisht nga ligji, ne rastin e zmadhimit te kapitalit, Aksionerave u takon e drejta e parablerjes mbi aksionet e caktuara rishtazi ne perpjestim me numrin e aksioneve qe ata zoterojne. Zmadhimi i kapitalit mund te kryhet edhe permes kontributeve ne natyre dhe kredive ose pa pagese nepermjet kalimit ne kapitalin e rezervave ose ne fonde te tjera te disponueshme.
- 5.3 Asambleja e Pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e Shoqerise ne perputhje me ligjin, me kusht qe kapitali mos te zbrese nen vleren minimale te parashikuar nga ligji.
- 5.4 Aksionerit mund te kryejne, me kerkese te Organit Administrativ, financime pa detyrimin e rimbursimit ose me rimbursim, me pagese ose falas, qe nuk perbejne mbledhje te kursimeve ndemjet publikut ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi ne fushen bankare dhe kreditore.




Neni 6 – Aksionet

- 6.1 Aksionet janë të zakonshme.
- 6.2 Akti i emetimit të aksioneve hartohet në momentin e emetimit fillestar të aksioneve, duhet të përmbajë informacionet dhe të respektojë procedurat e parashikuara nga ligjet në fuqi.
- 6.3 Çdo aksion jep të drejtën e një vote.
- 6.4 Administratori do të hartojë dhe mbajë një Regjister të Aksionareve të Shoqërisë në selinë e Shoqërisë, i cili duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e Aksionarit, ose emertimin e shoqërisë nëse Aksionari është person juridik, numrin e aksioneve, vlerën nominale të aksioneve, adresën ose selinë e Aksionareve dhe datën e regjistrimit të aktit.
- 6.5 Aksionaret e regjistruar në Regjistrin e Aksionareve do të prezumohen Aksionare të Shoqërisë me të drejtë të plota si në marrëdhëniet me Shoqërinë ashtu edhe ndaj paleve të treta.

Neni 7 – Transferimi i Aksioneve

- 7.1 Aksionet janë të ndashme dhe të transferueshme si *inter vivos* ashtu edhe nëpërmjet trashëgimisë pas vdekjes (trashëgimtarci duhet të emerojnë një përfaqësues të përbashkët, me kufizimet e caktuara nga neni i mëposhtëm).
- 7.2 Në rastin kur Aksioneri vendos që të transferojë kundrejt pagesës aksionet e Shoqërisë tek palët e treta, e drejta e nënshkrimit dhe e parablerjes i takon Aksionereve të tjerë, dhe prandaj ato janë të transferueshme sipas kushteve të përcaktuara nënçel më poshtë.
- 7.3 Termi "transferim" i referohet çdo dyqani, me ose pa pagesë, i cili ka për objekt pronësinë e plote ose pronësinë e zhveshur ose uzufektin e këtyre aksioneve ose të drejtave, në bazë të të cilave kryhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndryshimi i pronësisë të këtyre aksioneve ose të drejtave. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, shitjen, dhurimin, shkëmbimin, shkëmbimin shoqërisë, dhënien e kontributeve, shpërblimino natyre, transferimin "në bllok", "me detyrim" ose "të detyrueshëm", transmetimi që ndodh si rezultat i shitjes ose transferimit të shoqërisë, bashkimit dhe ndarjes së shoqërisë.
- 7.4 Në këtë rast, Aksioneri transferues duhet t'i njoftojë me shkrim Aksionerëve të tjerë, nëpërmjet letrës rekomandë me kthim përgjigje ose Postes Elektronike të Çertifikuara (në vijim "Njoftimi") (a) numrin e aksioneve të ofruara; (b) emrin e palës së treta blerëse/perfituese; (c) çmimin e rënë dakord për çdo aksion i cili duhet të përcaktohet në çdo rast në para' ose vlerën e shpërblimit tjetër të mundshëm (d.m.th. në rast shkëmbimi dhe në raste të tjera të cuditimit kundrejt pagesës); (d) menyrat e pagesës; (e) ftesën për të ushtruar të drejtën e parablerjes me kusht që termat dhe kushtet e tjera që mund të jenë rënë dakord midis transferuesit dhe palës së treta blerëse/perfituese nuk do të jenë rënduese për Aksionerët e tjerë që do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes duhet, gjithsesi, t'i referohet të gjitha aksioneve të ofruara në shitje.
- 7.5 Aksionerët do të kenë 30 (tridhjetë) ditë kohë nga marrja e Njoftimit për t'i njoftuar Aksionerit transferues vullnetin e tyre për të ushtruar ose jo të drejtën e parablerjes. Në përfundim të afatit të përcaktuar, e drejta e parablerjes në favor të tyre do të konsiderohet si e dorëhequr.
- 7.6 Nëse oferta pranohet nga më shumë Aksionerë, aksionet e Aksionerit transferues do të ndahen midis Aksionereve që kanë ushtruar të drejtën e parablerjes, në përprojetim të drejtë me aksionet përkatëse që secili prej tyre voton, përveçse kur palët bien dakord ndryshe. Në asnjë rast ofertuesi nuk do të detyrohet të pranojë një ushtrim të pjesshëm të së drejtës së parablerjes. Në mungesë të ushtrimit të së drejtës së parablerjes ose dorëheqjes nga e drejta e parablerjes, aksionet e treguara në Njoftim mund t'i transferohen palës së treta kundrejt çmimit të përcaktuar aty.
- 7.7 Me përjashtim të pelqimit të shprehur me shkrim nga të gjithë Aksionerët e Shoqërisë, (i) nuk mund të transferohet e drejta e pronësisë mbi aksionet me akt midis të gjallëve pa shpërblim dhe



- (ii) nuk mund te krijohet dhe as te transferohet asnje e drejte reale mbi aksionet ne favor te paleve te ureta, me ose pa shperblim.
- 7.8 Kushtet e percaktuara me siper nuk do te zbatohen ne rastin e transferimit te aksioneve nga nje Aksionar te nje shoqeri kontrolluese e ketij Aksionari ose e kontrolluar nga ky Aksionar, ku me kontroll kuptohet zoterimi i 50%+1 i te drejtave te votes ne asamblee perkatese.
- 7.9 Transferimi i aksioneve midis Aksionereve te Shoqerise kryhet lirisht pa asnje detyrim per ushtrimin e se drejtes se parablerjes dhe nuk i aplikohen parashikimet e ketij neni 7.
- 7.10 Te gjitha njoftimet e kerkuara dhe transferimet e parashikuara nga ky nen duhet t'i dergohen edhe Shoqerise. Çdo transferim i se drejtes se pronesise mbi aksionet, si dhe krijimi apo transferimi i çfaredolloj te drejte mbi to, duhet te regjistrohet ne Regjistrin e Aksionereve te Shoqerise.
- 7.11 E drejta e parablerjes nuk mund te ushtrohet ne menyre te pjesshme.
- 7.12 Nese asnje nga Aksionerët nuk ka per qellim qe te bleje aksionet e ofruara nga ofruesi, ortakut ofrues mund te transferoje lirisht te gjitha aksionet tek bleresi origjinal i shenuar ne njoftim brenda tridhete (30) diteve nga data e marrjes se pergjigjes se aksionereve te tjere.
- 7.13 E drejta e parablerjes ushtrohet ne menyre te vlefshme vetem me kushtin qe subjekti qe ka per qellim te transferoje duhet te marre nje pjese proporcionale ne çdo derdhje ne kapitalin themeltar dhe/ose kredive, qofteme interresa ose jo, te kryera nga aksioneri qe transferon.
- 7.14 Shkelja e dispozitave te mesiperme e ben te pavlefshem çfaredolloj transferimi te aksioneve.

TITULLI IV
SEKSIONI I
ORGANET E SHOQERISE

Neni 8 – Organet e Shoqerise


Organet e Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Keshilli i Administrimit;
- 3) Administratori;
- 4) Ekspertët/Kontabel i/te Regjistruar.

SEKSIONI II
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 9 – Asambleja e Pergjithshme

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise.
- 9.2 Çdo Aksionar ka te drejten te marre pjese ne Asamblee e Pergjithshme, te shprehe mendimin e tij dhe te ushtroje te drejten e votes ne perpjestim me aksionet qe zoteron.
- 9.3 Çdo Aksionar mund te perfaqesohet ne Asamblee e Pergjithshme nga nje person tjetër, jo domosdoshmerisht Aksionar, ne baze te nje autorizimi me shkrim. Ne çdo rast, autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblee te Pergjithshme dhe eshte e vlefshme per thirrjen e saj te pare dhe te dyte.
- 9.4 Nje Aksionar nuk mund te leshoje nje autorizim per nje pjese te aksioneve qe zoteron dhe te votoje personalisht per pjesen tjetër te aksioneve te tij.
- 9.5 Asambleja e Pergjithshme mund te mbledhet edhe ne vendndodhje te ndryshme nga selia e Shoqerise, ne Shqiperi ose jashte saj.



- 9.6 Asambleja e Pergjithshme mund te thirret me kerkese te Keshillit te Administrimit dhe/ose Administratorit dhe/ose te Aksionareve te cilet zoterojne te pakten 5% (pese per qind) te kapitalit themeltar, sa here qe te jete e nevojshme per intercesat e Shoqerise. Ne qdo rast, Asambleja e Pergjithshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit, brenda muajit qershor, me qellim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor te vitit ushtrimor te meparshem.
- 9.7 Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, i nenshkruar nga Kryetari i Keshillit te Administrimit, duhet te behet me leter rekomande me kthim pergjigje ose me poste elektronike te certifikuar, te derguar ne adresen e Aksionareve te treguar ne Regjistrin e Aksionareve, te pakten 21 (njetzet e nje) dite perpara dates se vaktuar per mbledhjen e Asamblese.
- 9.8 Njoftimi duhet te tregojë rendin e dites, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe menytrat e pjesemarrjes dhe te vendimmarrjes.
- 9.9 Asambleja e Pergjithshme konsiderohet e thirrur dhe e mbledhur rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te thirrjes, nese Aksioneret qe perfaqesojne te gjithe kapitalin e Shoqerise jane te pranishem ne mbledhje ose te perfaqesuar me autorizim.
- 9.10 Asambleja e Pergjithshme kryesohet nga Kryetari i Keshillit te Administrimit. Ne rast mungese apo pengese te Kryetarit, Asambleja kryesohet nga Zv./Kryetari, nese eshte emeruar ose nga Keshilltari me i moshuar. Asambleja e Pergjithshme duhet te emeroje nje sekretar, i cili mund te mos jete njeri prej Aksionareve.
- 9.11 Asambleja mund te mbledhet edhe jashte selise ligjore, ne Shqiperi ose jashte saj. Asambleja mund te mbahet edhe nepermjet telekonferences apo videokonferences, me kusht qe te gjithe te pranishmit te mund te identifikohen dhe t'u jepet mundesia per te ndjekur diskutimet dhe per te marre pjese ne kohe reale ne trajtimin e ceshtjeve dhe per te votuar njekohesisht mbi ceshtjet ne rend te dites; pasi te plotesohen keto kerkese, te cilat duhet te regjistrohen ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbledhur ne vendin ku ndodhen Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.
- 9.12 Kryetari i mbledhjes ka kompetenca te plota per te kontrolluar rregullsine e autorizimeve dhe te drejten e Aksionareve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, me qellimin per te vertetuar nese Asambleja eshte thirrur rregullisht dhe nese eshte arritur kuorumi i nevojshem per te marre vendime. Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe per eaktuar metodat dhe procedurat e votimit, pervec rastit kur Statuti per eaktion ndryshe.
- 9.13 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesemarrjesve hartohen pas qdo mbledhje dhe nenshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblese, ose nga noteri, nese eshte e nevojshme.

Neni 10 – Kuorumi dhe kompetencat e Asamblese se Pergjithshme


- 10.1 Ne rastet e vendimeve te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime ne menyre te vlefshme nese jane te pranishem Aksioneret qe zoterojne 50% plus nje aksion (pesedhjetë per qind plus nje aksion) te aksioneve me te drejte vote. Mungesa e kuoromit konstitutiv pengon votimin. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mbledhet per shtak te mungeses se kuoromit ne thirrjen e pare, Asambleja mund te mbledhet me te njejtin rend dite, brenda dhe jo me voue se 7 (shtate) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme, si ne thirrjen e pare dhe ne ato te dyte, merren me miratimin e te pakten 50% plus nje aksion (pesedhjetë per qind plus nje aksion) te kapitalit themeltar, pervec rasteve kur ky Statut parashikon ndryshe.
- 10.2 Asambleja e zakonshme vendos per ceshtjet e meposhme:
- per caktimin e politikave tregtare te Shoqerise (Buxheti);
 - miratimin e bilancit;
 - te ndermarre veprime gjyqesore ndaj anetareve te Keshillit te Administrimit dhe/ose Administratoreve;

- (d) emerimin dhe shkarkimin e anetarve të Keshillit të Administrimit në bazë të nenit 11 të këtij Statuti dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
 - (e) emerimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabel dhe/ose likuiduesve dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
 - (f) transferimin tek palet e treta, i pronësive dhe i menaxhimit të shoqërisë ose të degëve të saj;
 - (g) blerjen nga palet e treta, të pronësive dhe menaxhimit të shoqërisë ose të degëve të saj;
 - (h) blerjen dhe shitjen e aksioneve;
 - (i) blerjen dhe shitjen e pronave;
 - (j) blerjen dhe shitjen e asetëve (pasurive materiale) me një vlerë prej më shumë se 5.000.000 lekë;
 - (k) aplikimet për kredi, garanci dhe /ose kredi bankare ose sigurimi me vlerë mbi 5.000.000
 - (l) çdo çoshje tjetër të parashikuar nga ligji apo Statuti, përveç kur Statuti parashikon shprehimisht një shumicë më të madhe të cilesuar.
- 10.3 Në rastet e vendimeve të jashtëzakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime në mënyrë të vlefshme nëse janë të pranishëm Aksionaret që zoterojnë më shumë se 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind) të aksioneve me të drejtë voto. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit në thirrjen e parë, Asambleja mund të mbledhet me të njëjtin rend dite, brenda dhe jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas thirrjes së parë. Vendimet e jashtëzakonshme, si në thirrjen e parë edhe në thirrjen e dytë, merren me miratimin e të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind) të kapitalit themeltar.
- 10.4 Asambleja e jashtëzakonshme vendos mbi çështjet e mëposhtme:
- (a) ndryshimet e Statutit të Shoqërisë;
 - (b) vendimin për kryerjen e transaksioneve që faktikisht ndryshojnë objektin e Shoqërisë të përcaktuar në aktin e themelimit (duke përfshirë, por pa u kufizuar në kontributin në kapital ose cedimin e ndërmarrjes);
 - (c) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - (d) shpërndarjen e fitimeve;
 - (e) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - (f) krijimin e aksioneve të kategorive të tjera, ndryshimin e të drejtave mbi aksionet e kategorive të ndryshme ose blerjen e aksioneve të veta nga ana e Shoqërisë në rastet e parashikuara nga ligji;
 - (g) emetimin e obligacioneve;
 - (h) vendime për kryerjen e transaksioneve që sjellin një ndryshim të konsiderueshëm të të drejtave të Aksionerëve;
 - (i) riorganizimin, transformimin, ndarjen e aktivitetit, ndarjen, bashkimin, likuidimin ose prishjen e Shoqërisë si dhe riorganizimin në një formë tjetër.

SEKSIONI III KESHILLI I ADMINISTRIMIT

Neni 11 – Keshilli i Administrimit

- 11.1 Keshilli i Administrimit përbëhet nga tre anetarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe mund të mos jenë Aksionarë të Shoqërisë. Anetarët e Keshillit të Administrimit emërohen për një afat tre (3) vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Një anetar i Keshillit të Administrimit mund të emërohet si Administrator i Shoqërisë.
- 11.2 Anetari i Keshillit të Administrimit që heq dorë nga detyra duhet të njoftojë me shkrim Keshillin e Administrimit. Doreheqja ka efekt të menjhershëm nëse qendron në detyrë shumica e Keshillit të Administrimit ose në rast të kundërt, Asambleja për emerimin e Keshillit të ri thirret.



me urgjence nga anetaret e Keshillit te mbetur ne detyre ose nga Administratori. Mbarimi i mandatit te Keshillit te Administrimit per shkak te mbarimit te afatit ka efekt nga momenti ne te cilen eshte riemruar Keshilli i Administrimit (*prorogatio*). Keshilli i Administrimit *neprorogatio* nuk peson asnje reduktim te kompetencave.

11.3 Keshilli i Administrimit do te perbehet nga personat e meposhtem:

- **Kryetar**, Z. Vesel Demiraj, lindur me 13.02.1967, ne Lalez, Durres, mbajtes i pasaportes me nr. BB8676968, dhe nr personal G70213046W;
- **Anetar**, Znj. Dorina Morina, lindur me 11.07.1983, ne Fier, Shqiperi, mbajtese e kartes se identitetit nr. BE2129391, dhe nr. personal I35711083Q.
- **Anetar**, Z. Nicola Carone, lindur me 19 Maj 1978, ne Terlizzi (BA), Itali, mbajtes i pasaportes italiane me nr. YA2501216.

Neu 12 – Mbledhjet e Keshillit te Administrimit

- 12.1 Keshilli i Administrimit mund te thirret ne çdo moment nga Kryetari, edhe me kerkesen me shkrim te Asamblese se Pergjithshme ose te pakten te njerit prej anetareve te Keshillit te Administrimit ose te Administratorit dhe sa here qe te jete e nevojshme per interesat e Shoqerise. Keshilli i Administrimit thirret me ane te nje letre rekomande, telefaksi, postes elektronike te çertifikuar PEC ose me e-maili, te derguar te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes. Ne rast urgjence, mbledhja mund te thirret nepermjet telefaksit, postes elektronike te çertifikuar ose e-mail-it te derguar te pakten 24 ore perpara dates se caktuar per mbledhjen. Ai qe ka thirrur keto mbledhje duhet te sigurohet se te gjithë anetaret e Keshillit te Administrimit e kanë marre efektivisht njoftimin e derguar nepermjet postes elektronike, duke u kerkuar secilit dergimin e nje pergjigje me e-maili per te konfirmuar marrjen e njoftimit. Njoftimi duhet te tregoje rendin e dites, vendin, oren dhe daten e mbledhjes. Ne rast se Kryetari mungon ose per çfaredolloj arsye nuk mund te marre pjese ne mbledhje, te gjitha kompetencat e pershkruara ne keto nen i transferohen Zv./Kryetarit nese eshte emruar dhe eshte i pranishem ose anetarit me te vjeter ne detyre te Keshillit te Administrimit te pranishem ne mbledhje ose nese ai mungon personit te percaktuar nga shumica e anetareve te Keshillit te pranishem ne mbledhje. Edhe nese nuk jane permbushur te gjitha formalitetet e nevojshme per thirrjen, Keshilli i Administrimit do te qubet i mbledhur rregullisht nese te gjithë anetaret e Keshillit jane te pranishem ne mbledhje.
- 12.2 Keshilli i Administrimit emeron nje sekretar per te mbajtur procesverbalin e mbledhjeve.
- 12.3 Keshilli i Administrimit mbledhet ne seline e Shoqerise ose ne nje vend tjeter ne Shqiperi ose ne Itali dhe mund te mbahet edhe me telekonference apo video conference, me kusht qe te gjithë te pranishmit te mund te identifikohen dhe t'u jepet mundesia per te ndjekur diskutimet dhe per te marre pjese ne to si dhe per te votuar njekoheisht mbi çeshtjet ne rend te dites. Pasi te plotesohen keto kushte, Keshilli konsiderohet i mbledhur ne vendin ku ndodhen Kryetari dhe sekretari i mbledhjes, per te mundesuar mbajtjen e procesverbalit.
- 12.4 Keshilli i Administrimit qubet rregullisht i mbledhur nese eshte e pranishme te pakten shumica e thjeshte e anetareve te tij (d.m.th. 50% + 1 e anetareve).
- 12.5 Nje vendim i Keshillit te Administrimit mund te merret edhe me ane te nje vendimi qarkullues, me kusht qe (i) drafti i vendimit, se bashku me te gjithë dokumentacionin e nevojshem per te vleresuar thelbin e çeshtjes objekt i vendimit t'ju dergohen te gjithë anetareve te Keshillit te Administrimit dhe (ii) vendimi te jete nenshkruar nga te gjithë anetaret e Keshillit te Administrimit dhe secili prej tyre te kete shprehur pozicionin perkates ne lidhje me çeshtjen. Data e vendimit do te jete ajo ne te cilen vendimi do te nenskruhet nga i fundit prej anetareve te Keshillit te Administrimit. *Kuorumi* vendimmarres eshte ai qe percaktohet ne nenin 12.6 ne vijim.



- 12.6 Vendimet e Keshillit të Administrimit konsiderohen të marra vlefshmerisht nëse miratohen nga shumica e anëtarëve të pranishëm. Në rast barazie, mbizoteron vota e Kryetarit të Keshillit të Administrimit.
- 12.7 Vendimet dhe procesverbalet hartohen pas çdo mbledhje dhe duhet të nënshkruhen nga Kryetari ose nga zëvendësi i tij dhe nga sekretari i mbledhjes.

Neni 13 – Kompetencat e Keshillit të Administrimit

- 13.1 Keshilli i Administrimit ka të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që i rezervohen ekskluzivisht organeve të tjera nga ky Statut ose nga ligjet në fuqi.
- 13.2 Keshilli i Administrimit ka, gjithashtu, kompetencën për të emëruar dhe revokuar përfaqësues “*ad negotia*” për kryerjen e detyrave specifike.

SEKSIONI IV ADMINISTRATORET

Neni 14 – Administratoret

- 14.1 Keshilli i Administrimit, me përcaktim të Asamblesë së Përgjithshme, emëron një person fizik si Administrator të Shoqërisë për një periudhë prej 3 (tre) vjet; Administratori mund të riemërohet.
- 14.2 Administrator i shoqërisë do të jetë z. Aleksander Rako Pindori lindur më 14.03.1964 në Korçë dhe banues në Tiranë, mbajtes i letërnjoftimit me nr. Personal G40314131D, për një periudhë 3 (tre) muajore nga data 30.03.2018 deri më 30.06.2018
- 14.3 Përfundimi i mandatit të Administratorit për shkak të mbarimit të afatit ka efekt nga momenti në të cilin është emëruar Administratori i ri (*prorogatio*). Administratori në *prorogatio* nuk pëson asnjë reduktim të kompetencave.
- 14.4 Në kuadër të kompetencave të deleguara nga Keshilli i Administrimit, përveç kompetencave të dhëna nga ligji, Administratori:
- ndermerr nismat për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të përcaktuara nga Keshilli i Administrimit, duke mbikëqyrur veprimtarinë e Shoqërisë;
 - i propozon strukturën e brendshme organizative të Keshillit të Administrimit;
 - kujdeset për përgatitjen e skemës dhe kontrollin e të gjitha akteve që i nënshtrohen vendimmarjes së Keshillit të Administrimit, si dhe zbatimin e vendimeve të Keshillit të Administrimit;
 - drejton personelin, duke ndjekur udhëzimet e Keshillit të Administrimit, duke marrë në këtë drejtim masat që kanë të bëjnë me statusin ligjor dhe ekonomik të vete stafit, edhe gjatë lidhjes së marrëdhënies së punës dhe menaxhon negociatat dhe lidhjet marreveshjet sindikale, brenda kuadrit të politikave sindikale të përcaktuara nga Keshilli i Administrimit;
 - ndermerr veprime gjyqësore dhe mbrohet ndaj tyre, duke pasur të drejtën t'i zgjidhë në mënyrë miqësore ose të lidhje marreveshje, nëse bëhet fjalë për veprime për mbledhjen e kredive që rrjedhin nga ushtrimi i veprimtarisë së zakonshme të Shoqërisë ose nga mosmarreveshjet e punës;
 - kujdeset, brenda kufijve të kompetencave, për blerjet dhe për shpenzimet e nevojshme për funksionimin e Shoqërisë;
 - hap, fshin dhe mbyll llogaritë rrjedhëse në institutet bankare dhe jobankare dhe përcakton linjat e kredive në emër e për llogari të Shoqërisë, edhe në valute të huaja si dhe administron të gjitha marrëdhëniet me institutet bankare dhe jobankare;

- (h) informon, gjithsesi, Asamblene e Aksionereve dhe Keshillin e Administrimit mbi çdo çështje për të cilën kërkohej shprehimisht çfaredolloj informacioni prej tyre;
 - (i) brenda kufijve të kompetencave, blen dhe/ose transferon pasuri të paluajtshme dhe kryhen të gjitha veprimet me pasuri të paluajtshme brenda kufijve të Buxhetit ose të Planit të Biznesit;
- 14.5 Administratori informon, gjithsesi, Keshillin e Administrimit mbi çdo çështje për të cilën kërkohej shprehimisht çfaredolloj informacioni nga ky i fundit, me kusht që ky informacion të hyjë brenda kufijve të kompetencave të tij. Administratori ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Keshillit të Administrimit me të drejtën për të nderitur por pa të drejtë vote.
- 14.5 Administratori mund të emerojë një/ine shumë përfaqësues "ad negotia" për kryerjen e detyrave specifike ose kategorive të detyrave, brenda kufijve të kompetencave të dhëna nga Statuti ose nga ligji.

Neni 15 – Përfaqësimi i shoqërisë

Firma dhe përfaqësimi i Shoqërisë kundrejt palëve të treta janë të ndara nga Administratori brenda kufijve kompetencave të dhëna dhe sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe ligjit si dhe përfaqësuesve brenda kufijve të kompetencave që u janë dhëna.

SEKSIONI V EKSPERTET KONTABEL TË REGJISTRUAR

Neni 16 – Ekspertet kontabel të regjistruar

Auditimi i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga një ose më shumë eksperte kontabel të regjistruar të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për çdo vit financiar.

Eksperti kontabel për vitin 2018 është Shoqëria audituese "Public Accounting Service Union and Trust" SHPK, me NIPT L21423032S, me auditues ligjor znj. Ilda Duhaxhiu, regjistruar me Vendimin nr. 32, të Autoritetit të Regjistrimit (IEKA) për auditimin e Pasqyrave Financiare.

Mandati i mandatit është 1 vjeçar.

TITULLI V VITI FINANCIAR, FITIMET


Neni 17 – Viti financiar

Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 18 - Fitimet

- 18.1 Fitimet neto sikurse rezultojnë nga bilanci do t'u shpërndahen Aksionereve me vendim të Asamblese së Përgjithshme, pasi të jete zbritur shuma e barabartë me 5% (pese për qind) e cila do ruhet si rezerve ligjore, deri sa kjo rezerve të jete e barabartë me 10% (dhjete për qind) të kapitalit të themeluar të Shoqërisë dhe pasi të jete zbritur të gjitha shumat që Asambleja e Përgjithshme ka vendosur të ruhen si rezerve.
- 18.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të krijojë rezerva të tjera të jashtëzakonshme ose specifike.

TITULLI VI PRISIIJA – NDARJA BASHKIMI - LIKUIDIMI



Neni 19 – Prishja – Ndurja Bashkimi

- 19.1 Shoqeria mund të priset për shkak të parashikuara nga ligji. Në rast prishjeje, Asambleja e zakonshme e Aksionareve emerohet një ose me shumë likuidues duke u caktuar kompetencat përkatëse.
- 18.1 Shoqeria mund të priset, udhëtohet apo bashkohet me vendim të Asamblese së jashtëzakonshme të Aksionareve.

Neni 20 – Likuidimi

- 20.1 Në rast prishjeje Shoqeria duhet të likuidohet.
- 20.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e zakonshme e Aksionareve emerohet një ose me shumë likuidues, të cilët duhet të hartojnë raportin përfundimtar mbi fitimet dhe detyrimet e Shoqerisë, dhe mbi procedurat dhe kohen e nevojshme për likuidimin.
- 20.3 Në përfundim të procedurave të likuidimit, Asambleja e jashtëzakonshme e Aksionareve do të vendosë mbi bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesit dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
- 20.4 Pas shlyerjes së kreditorëve, likuiduesit do t'u shpërndajë Aksionareve fitimet e mbetura në përprojetim me aksionet që ata zotërojnë.

TITULLI VII TE NDRYSHME

Neni 21 – Zgjidhja e mosmarrveshjeve

- 21.1 Ky Nen do të jetë efektiv në rastin e dy aksionereve me pjesëmarrje të njëjtit ose ndryshe të barabartë me 50% secili në kapitalin themelues.
- 21.2 Në rastin e përmendur në nenin 21.1 në prani të dy Keshillave të njëpasnjeshme të Administrimit ose dy mbledhjeve të njëpasnjeshme të Aksionareve, të cilat nuk janë mbajtur për shkak të mungesës së kuorumit ose janë përfunduar pa marrë vendim ose me një vendim për azhurmim në një datë tjetër, Organi Administrativ, me kërkesën e njerit prej dy aksionereve duhet që brenda 10 ditëve nga kjo kërkesë të dërgojë tek aksionaret me anë të postës elektronike të çertifikuara PEC dhe/ose me leter rekomandimi me kthim përgjigje, një kërkesë për caktimin e një arbitri për secilin prej aksionareve me qëllim që të zgjidhet me mirëkuptim faza e bllokimit të marrjes së vendimeve. Aksionaret do të kenë kohë, brenda dhe jo vonë se 30 ditë nga dërgimi i kërkesës formale të Organit Administrativ, për t'i njoftuar atij që nuk ekzistojnë me arsyet që kanë përcaktuar bllokimin e marrjes së vendimeve.
- 21.3 Në rast të mosrespektimit të paragrafit të mëparshëm 21.2, Organi Administrativ ose anetari me i kujdesshëm në rastin e refuzimit të Organit Administrativ, brenda 10 ditëve nga mos arrija e marrveshjes duhet t'i dërgojë aksionareve, me anë të postës elektronike të çertifikuara PEC dhe/ose me leter rekomandimi me kthim përgjigje, emrin e noterit të zgjedhur (i cili në rast të mos arrijës së një marrveshjeje do të caktohet nga arbitri i referuar në nenin 21.1 me kërkesën e palës përkatëse), në të cilën aksionaret duhet të dërgojnë ofertat e tyre përkatëse në një zarf të mbyllur brenda tridhjetë ditëve. Oferta duhet të tregojë çmimin e ofruar për blerjen e të gjitha pjesëmarrjeve të aksionarit tjetër dhe një pagesë me çek bankar e barabartë me 10% të çmimit të ofruar. Zarfet që përmbajnë ofertat duhet të hapen nga noteri i zgjedhur në praninë e aksionareve ose delegatëve të tyre ose përfaqësuesve ligjorë të aksionareve të Shoqerisë ose agjentit të tyre të posaçëm në datën e treguar nga noteri i zgjedhur pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Noteri duhet të tregojë, për hapjen e ofertave, një datë jo më vonë dhjetë ditë pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave.



- 21.4 Aksionari i cili do të ketë caktuar çmimin me të lartë do të përfitojë të gjithë aksionet e mbajtura nga aksionari tjetër.
- 21.5 Në rastin e paraqitjes të një oferte të vetme, aksionet do t'i jepen menjëherë aksionarit që ka bërë ofertën me çmimin e përcaktuar në ofertë. E njëjta gjë do të ndodhë edhe në rastin e një oferte të pavlefshme pra pa pagesën e cekut bankar për shumën e treguar me sipër.
- 21.6 Në rast se aksionerët kanë dhënë me parë garancitë dhe/ose hua në lidhje me Shoqërinë, garancitë ose huatë e tilla duhet të hiqen dhe/ose të kthehen në të njëjtën kohë me blerjen e aksioneve të Shoqërisë.
- 21.7 Notari brenda tridhjetë ditëve nga data e hapjes së zarfeve do të caktojë datën, kohën e transferimit dhe do të therrë aksionerët për nënshkrimin. Njoftimi me aksionerët me rezultatin e ofertes duhet të merret së paku njëzet ditë para datës së noterizimit (për këtë qëllim notari mund të dorëzojë në kohën e hapjes së zarfit një kopje të vendimit që tregon datën e caktuar për aktin noterial).
- 21.8 Blerja do të konsiderohet e përfunduar në momentin e pagesës së çmimit me anë të cekut bankar dhe nënshkrimit të aktit noterial përkatës. Kuptohet që blerja duhet të bëhet edhe me titullin përkatës të aksionarit cedues nga garancitë dhe rimbursimet e çdo kredie të ofruar nga ai ndaj Shoqërisë.
- 21.9 Nëse brenda 10 ditëve pas datës së përcaktuar për nënshkrimin e aktit noterial nuk është kryer transferimi i pagës, për arsye të shkakutara nga blerësi, aksionari që rezultoi shites do të ketë të drejtën të blejë me çmimin e ofruar nga ai pjesën e aksionarit blerës duke paguar me cek bankar dhe aktin noterial kontekstual njëkohësisht duke bërë të mundur në të njëjtën kohë lirimin e aksionarit cedues nga garancitë dhe rimbursimin e ndonjë kredie të dhënë nga ai për Shoqërinë.
- 21.10 Në rastin e shitjes së investimeve nëpërmjet procedurës "Blej ose Shit", rregullat për transferimin e aksioneve në lidhje me të drejtën e parablertjes nuk do të zbatohen.

Neni 22 – Gjuha

Ky Statut hartohet në gjuhën shqipe dhe italiane. Në rast mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij Statuti, versioni në gjuhën italiane do të jetë mbizotërues dhe detyrues dhe i vetmi version me fuqi ligjore.


Neni 23 – Dispozita përfundimtare

Çeshtjet që nuk parashikohet shprehimisht nga ky Statut do të rregullohen nga ligji shqiptar për Shoqëritë Tregtare.

Tiranë, më 30.03.2018

AKSIONERI

Vesil Demiraj



**STATUTO
DELLA SOCIETA' PER AZIONI
"PELIKANT MONDIALPOL" SHA**

**TITOLO I
DENOMINAZIONE DELLA SOCIETA' - SEDE - DURATA**

Articolo 1 - Denominazione della società

- 1.1 IN seguito si approva lo statuto della società "PELIKANT MONDIALPOL" SHA (in seguito "Società"), una società per azioni con offerta privata.
- 1.2 La Società ha il suo timbro e il suo logo ufficiale.

Articolo 2 - Sede

- 2.1 La sede della Società è in Tirana, Kashar, Lagjia Koder Kashar, Autostrada Tirane - Durres Km. 9, Rruga Iliria, Godina Nr. 1, Zona Kadastrale 2105, Albania.
- 2.2 L'Assemblea Generale potrà decidere l'apertura di filiali, sedi secondarie, rami e rappresentanze in altre città dell'Albania ed anche all'estero.
- 2.3 Per quanto riguarda le relazioni tra la Società e gli azionisti (in seguito "Azionisti" o "Soci"), l'indirizzo di ognuno degli Azionisti è quello che risulta nel Registro degli Azionisti della Società. Nel caso in cui venga cambiato l'indirizzo, gli Azionisti sono tenuti ad informare in forma scritta la Società e tale modifica deve essere iscritta nel predetto registro.


Articolo 3 - Durata

- 3.1 La durata della Società è 31/12/2050 con possibilità da parte dell'Assemblea Generale di prorogare il termine una o più volte.
- 3.2 La Società potrà essere sciolta per deliberazione dell'Assemblea Generale o per disposizioni della legge applicabile.

**TITOLO II
L'OGGETTO**

Articolo 4 - Oggetto Sociale

- 4.1 L'oggetto sociale prevalente della Società sarà l'accompagnamento, trasporto e deposito di oggetti di valore, elementi monetari e di valore, per conto proprio e di terzi, mediante l'utilizzo di veicoli propri, in comodato, noleggio e in locazione anche finanziaria, nonché la custodia di valori in caveaux o cassette di sicurezza, la gestione di sale contazione e collettoria per la lavorazione in genere di denaro, assegni titoli e loro cedole, valori assimilati di proprietà di terzi in conformità con i requisiti di legge, secondo la categoria "C", così come ogni attività ausiliaria necessario per soddisfare e riempire l'oggetto come con sopra. Questa attività sarà esercitata sulla base di permessi e licenze pertinenti rilasciate dalle autorità competenti.
- 4.2 La produzione e la vendita in ogni forma di abbigliamento in particolare di abbigliamento tecnico e militare (divise guardie private, ecc),
- 4.3 La gestione di servizi di vigilanza in aree portuali e aeroportuali, in particolare la vigilanza aeroportuale e portuale e di particolari postazioni all'interno del sedime aeroportuale e portuale, di pertinenze delle società di gestione, di un vettore aereo o nautico o di un altro operatore aeroportuale e portuale (ingresso, uffici, varco merci,



perimetro aeroportuale e portuale e piantonamento mobile); la vigilanza ai magazzini merci import-export ed i relativi varchi, la vigilanza a partite merci di particolare valore con relativa scorta - custodia del magazzino all'aeromobile e/o nave e/o imbarcazione e viceversa, la scorta - custodia di valori armi al seguito di passeggeri, il controllo radiogeno del bagaglio registrato, "Rush" e a mano, il riconoscimento bagagli sottobordo; il controllo di passeggeri ai gates di imbarco e sotto l'aereo e/o nave prima dell'imbarco effettivo, intervista ai passeggeri prima dell'imbarco.

- 4.4 La Società può compiere, inoltre, tutte le operazioni che risultano necessarie o utili per il conseguimento degli scopi sociali; a titolo esemplificativo potrà porre in essere operazioni immobiliari, mobiliari, commerciali, industriali e finanziarie, partecipare a procedure ad evidenza pubblica per l'assunzione della gestione di servizi di interesse economico generale o per altre attività comunque utili per il raggiungimento dell'oggetto, nonché compiere qualunque atto che sia comunque collegato con l'oggetto sociale, ad esclusione della raccolta di risparmio tra il pubblico e dell'esercizio delle attività oggetto di riserva di legge. La Società può, infine, assumere partecipazioni ed interessenze in altre società, consorzi o imprese, sia nazionali che straniere, nonché costituire società aventi oggetto simile, complementare, ausiliare, analogo, affine al proprio o a quello delle società alle quali partecipa, od anche aventi oggetto differente, sia direttamente che indirettamente, sotto qualsiasi forma, nonché gestire le partecipazioni e/o interessenze medesime, purché dette partecipazioni od interessenza o società non modificchino la sostanza degli scopi sociali; può, inoltre, prestare garanzie reali e/o personali per obbligazioni connesse allo svolgimento dell'attività sociale anche a favore di terzi, anche soci.

TITOLO III CAPITALE - AZIONI - TRASFERIMENTO DELLE AZIONI

Articolo 5 - Capitale

- 5.1 Il capitale sottoscritto e interamente versato della Società è di 9.800.000Lekë, ed è composto da 5.000 di azioni con un valore nominale di 1960Lekë ognuna. Il capitale è sottoscritto e pagato come segue:
- Sig. il Sig. VeselDemiraj, nato il 13.02.1967, a Lalez, Durres, portatore della passaporto nr. BB8676968, e nr personale G70213046W, possiede 5000 azioni del valore di 1960 ciascuna, corrispondenti al 100 % del capitale sociale per un valore di 9.800.000Lekë;
- 5.2 L'Assemblea Generale può aumentare il capitale ai sensi della legge. Tranne che nei casi previsti espressamente dalla legge, in caso di aumento di capitale, ai Soci spetta il diritto di prelazione sulle nuove azioni emesse in proporzione al numero delle azioni che hanno già in proprietà. L'aumento di capitale può avvenire anche mediante conferimenti di beni in natura e di crediti o a titolo gratuito mediante passaggio a capitale di riserve o altri fondi disponibili
- 5.3 L'Assemblea Generale può ridurre il capitale della Società ai sensi della legge a condizione che il capitale non scenda al di sotto del valore minimo previsto dalla legge.
